



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE

Nr. _____ prot.

Elbasan, më _____.____.2026

LËNDA: Dërgim njoftimi për botim në Buletinin e Prokurimit Publik.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan

Drejtuar: **OE “Blerina Sadiku” P.Fizik me nipt K97730102T**, me adrese: Godinë 1
katëshe në Magjatë, pranë ish-uzinës së aviacionit, Magjate, Kucove

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** **X**

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO X**

Tipi i Kontratës: **MALL**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e Hapur e thjeshtuar**

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-92842-07-08-2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **09.07.2026**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: **Buletini Nr. 45 datë
13 Korrik 2026**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje Uniforma per punonjesit e nivelit baze te MZSH-se”, me fond limit **1,500,000** (njemilion e peseqindmije) **lekë pa tvsh** , vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2026.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike me e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomike me e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse, si më poshtë:

1. “Blerina Sadiku” P.Fizik me Nipt: K97730102T

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **1,466,300** (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e treqind) **lekë pa tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “Bledi Loçi” P.Fizik, me Nipt: L47401203N

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **1,479,850** (një milion e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) **lekë pa tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1.Operatori ekonomik “Bledi Loçi” P.Fizik, me Nipt: L47401203N

1. Keni paraqitur një formular sigurim oferte jo të sakte, pasi është për një procedurë tjetër prokurimi të zhvilluar nga një tjetër autoritet kontraktor, e konkretisht për AK Agjencia e Sherbimeve Funerale, me objekt: “Blerje vegla pune”. Nisur nga kjo sigurimi i ofertes i paraqitur është jo i vlefshëm, duke mos përmbushur pikën 1/b të kriterëve të vecanta për kualifikim.

2. Nuk keni paraqitur autorizim të prodhuesit/ve ose distributorit të autorizuar prej prodhuesit shoqëruar me katalog/skeda teknike për produktin objekt prokurimi, duke mos përmbushur pikën 2.3.2 të kriterëve të vecanta për kualifikim.

3. Nuk keni paraqitur asnje nga mostrat per artikujt e kerkuar, duke mos permbushur piken 2.3.4 te kriterëve te vecanta per kualifikim.

4. Nuk keni paraqitur asnje nga çertifikatat e produktit per artikujt e kerkuar, duke mos permbushur piken 2.3.5 te kriterëve te vecanta per kualifikim.

Sa më sipër, oferta juaj refuzohet.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **"Blerina Sadiku" P.Fizik**, me nipt **K97730102T**, me adrese: **Godinë 1 katëshe në Magjatë, pranë ish-uzinës së aviacionit, Magjate, Kucove**, se oferta e paraqitur me vlerën prej **1,466,300** (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e treqind) **lekë pa tvsh**, është identifikuar si ofertues i suksesshem.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV.KRYETARI
Asim Sula